REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

BULETINI MUJOR

Aktivitetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Shkurt 2020

1. Aktivitetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Reagim i Këshillit Prokurorial për kërcënimet ndaj prokurorit Rasim Maloku

Prishtinë, 3 shkurt 2020 – Këshilli Prokurorial i Kosovës dënon fuqishëm kërcënimin ndaj Prokurorit të Departamentit për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore të Ferizajt, Rasim Maloku, si dhe familjes së tij.

Këto kërcënime serioze ndaj Prokurorit Maloku dhe familjes së tij vijnë si rrjedhojë e procesit gjyqësor ndaj ish-kryetarit të Kaçanikut, Xhabir Zharku.

Këshilli Prokurorial qëndron fuqishëm në përkrahje të prokurorit Rasim Maloku dhe ofron mbështetje të plotë për punën e tij gjatë ushtrimit të funksionit në ndjekjen e kryesve të veprave penale.

KPK-ja siguron opinionin publik se kërcënimet ndaj prokurorëve nuk do t'i zmbrapsin synimet dhe përpjekjet e vazhdueshme për fuqizimin e shtetit ligjor, ndërsa kërkon nga organet kompetente që këtë rast ta trajtojë me seriozitetin dhe urgjencën e duhur.

Vazhdon puna në hartimin e draftit të Rregullores për vlerësimin e performancës së prokurorëve

Prishtinë, 3 shkurt 2020 – Këshilli Prokurorial i Kosovës më qëllim të avancimit të procesit të vlerësimit të performancës së prokurorëve ka themeluar Grupin punues për hartimin e Rregullores për vlerësimin e performancës së prokurorëve.

Grupi punues ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin ka punuar në finalizimin e draftit të rregullores së lartcekur, draft ky, të cilin pas draftimit do ta përcjellë për shqyrtim në Komisioni për Çështje Normative.

Kontribut të vazhdueshëm në hartimin e Rregullores përmes pjesëmarrjes aktive në takimet e grupit punues ka dhënë edhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni.

Vlen të theksohet se miratimi i kësaj rregulloreje do të ndikojë në avancimin e proceseve dhe procedurave për vlerësimin e performancës së prokurorëve.

Komisionit për Administrimin e Prokurorive diskuton Planin e punës për vitin 2020

Prishtinë, 4 shkurt 2020 – Komisioni për Administrimin e Prokurorive i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga kryesuesja e tij, Prokurorja Radica Milic, ka mbajtur takimin e parë në vitin 2020.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i zbatimit të Planit të Punës për vitin 2020, përcaktimi i aktiviteteve me prioritet për zbatim në muajin shkurt, si dhe çështje tjera të administrimit të prokurorive.

Anëtarët e Komisionit gjatë këtij takimi diskutuan edhe për vlerësimin e proceseve të punës në administratën e prokurorive, analizën për numrin e nevojshëm të prokurorëve, konsolidimin dhe zbatimin e punës përmes SMIL-it dhe hartimin e raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2019.

Në përmbyllje të takimit, Komisioni vendosi që të vazhdojë realizimin e vizitave në prokurori me qëllim që të bëhet inspektimi i regjistrave, vlerësimi i gjendjes së lëndëve të vjetra, vlerësimi i furnizimeve, si dhe gjendja e ndërtesave në prokurori.

Shqyrtohet rishikimi i Kërkesës buxhetore të KPK-së

Prishtinë, 5 shkurt 2020 – Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga Kryesuesja, Prokurorja Dëshirë Jusaj, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin përveç anëtarëve të tij, kanë marrë pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Lavdim Krasniqi dhe udhëheqësit e njësive përkatëse të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe rishikimi i Kërkesës buxhetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2020 dhe vlerësimet e hershme për buxhetin e vitit 2021-2022.

Lidhur me rishikimin e Kërkesës buxhetore të KPK-së, pas diskutimeve të mbajtura në këtë takim, u vendos të bëhen harmonizimet brenda kategorive ekonomike dhe projekteve kapitale, pa e tejkaluar kufirin buxhetor të miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Mbahet takimi i udhëheqësve të administratës së KPK-së dhe administratorëve të prokurorive

Prishtinë, 5 shkurt 2020 – Realizimi e planifikimit të avancuar të nevojave tremujore të prokurorive dhe njësive organizative të KPK-së, menaxhimi i pasurisë dhe ecuria e shkëmbimit të të dhënave në mes prokurorive dhe Policisë së Kosovës, ishin në fokus të takimit të sotëm të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Lavdim Krasniqi, Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, Valon Jupa, udhëheqësve dhe zyrtarëve të administratës së KPK-së dhe administratorëve të prokurorive.

Në këtë kontekst janë diskutuar edhe tema të tjera, siç janë: raportimet statistikore, niveli i cilësisë së të dhënave të raportuara, harmonizimi i tyre dhe njësimi me ato manuale, si dhe shtimi i efektivitetit dhe efikasitetit të përgjithshëm të procesit të punës, përfshirë implementimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL).

Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Lavdim Krasniqi, ka kërkuar nga administratorët që secila prokurori të hartojë draftin deri në fund të këtij muaji lidhur me nevojat për shërbime dhe të respektojë procedurat për zbatimin e nivelit të sigurisë së objekteve, sidomos përbrenda prokurorive të vendit.

Ndërsa në fund të këtij takimi u prezantuan edhe të dhënat për realizmin e projektit për arkiva, përmbylljen e vlerësimeve të punës së nëpunësve dhe realizimin e përkthimeve në sistemin prokurorial të Kosovës.

Kryesuesi Hyseni ka takuar ministren Haxhiu

Prishtinë, 10 shkurt 2020 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Bahri Hyseni, ka pritur në takim ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, të cilën pasi e ka uruar për pozitën e re, e ka njoftuar për punët e deritashme, prioritete dhe sfidat e sistemit prokurorial të Kosovës.

Kryesuesi Hyseni ka thënë se KPK-ja është duke punuar në vazhdimësi për krijimin e politikave dhe kushteve sa më të mira për një sistem prokurorial sa më efikas në hetimet dhe ndjekjen e kryerësve të veprave penale, ndërsa me theks të veçantë ka folur për prioritetet e sistemit prokurorial të Kosovës, e që janë lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në anën tjetër, ministrja Haxhiu, tha se do t'i mbështesë të gjitha proceset që ka sistemi prokurorial, në mënyrë që së bashku të çojnë përpara sundimin e ligjit në Kosovë.

Gjatë këtij takimi u bisedua edhe për buxhetin e sistemit prokurorial të Kosovës. Lidhur me këtë, ministrja Haxhiu shprehu gatishmërinë në ofrimin e ndihmës në kërkesat buxhetore të Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Në fund të takimit, të dy bashkëbiseduesit shprehen gatishmërinë për punë më të madhe me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës dhe transparencës në sistemin prokurorial të Kosovës.

Planifikohet zhvillimi i vizitave nëpër prokurori

Prishtinë, 12 shkurt 2020 – Kryesuesja e Komisionit për Administrimin e Prokurorive, Radica Miliq, ka mbajtur takim me Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Lavdim Krasniqi dhe Drejtorin e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, Valon Jupa.

Në këtë takim, i cili kishte karakter planifikues dhe organizativ, kryesuesja Miliq, së bashku me drejtorët Krasniqi dhe Jupa, kanë diskutuar për planifikimin e vizitave nëpër prokurori, me qëllim të koordinimit sa më të mirë të punëve lidhur me statistikat.

Po ashtu në takim është diskutuar edhe për procesin e punëve të realizuara për kalimin e Prokurorisë Themelore të Gjakovës në objektin e ri, objekt ky, i cili ofron kushte më të mira për punë.



Vazhdon puna në zhvillimin dhe funksionalizimin e uebportalit të sistemit prokurorial

Prishtinë, 13 shkurt 2020 – Grupi punues për zhvillimin e uebportalit të sistemit prokurorial të Kosovës ka mbajtur takimin e radhës, ku ka vazhduar punën për finalizimin e këtij uebportali.

Në këtë takim të pranishëm kanë qenë edhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, Lavdim Krasniqi, me ç'rast nga grupi punues janë njoftuar me punët e realizuara deri me tani në zhvillimin dhe funksionalizimin e uebportalit të sistemit prokurorial.

Po në këtë takim janë prezantuar edhe risitë, të cilat do t'i sjellë uebportali, risi këto, të cilat pritet të ndikojnë në ngritjen e transparencës dhe qasjen me të lehtë të qytetarëve.

Uebportali i sistemit prokurorial do të sjellë lehtësime të theksuara në veprimtarinë komunikuese, eliminim të dyfishimit të informacionit, fuqizim të informatave dhe lehtësimi për kalimin e tyre të publiku.

Mbahet takimi i Grupit punues për zhvillimin institucional të sistemit prokurorial

Prishtinë, 13 shkurt 2020 – Përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial të Kosovës kanë zhvilluar takimet me përfaqësuesit britanikë të Projektit "Forcimi i sistemit gjyqësor në Kosovë" në kuadër të grupit punues për zhvillimin institucional të sistemit prokurorial.

Gjatë këtij takimi, në të cilin morën pjesë Kryesuesja e Komisionit për Administrimin e Prokurorive, Radica Miliq, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, Lavdim Krasniqi, Drejtori i Njësitit për Shqyrtimin e Performansës së Prokurorisë, Valon Jupa, është diskutuar për Planin e aktiviteteve të Grupit punues për vitin 2020.

Rrjedhimisht, gjatë takimit, Grupi punues ka planifikuar angazhimin e mëtejshëm për zhvillimin një plani sa më funksional, i cili do të ndikojë në avancimin e performansës së KPK-së dhe PSH-së.

Reagim i Këshillit Prokurorial për kërcënimet e përsëritura ndaj prokurorit Rasim Maloku

Prishtinë, 19 shkurt 2020 – Këshilli Prokurorial i Kosovës dënon fuqishëm kërcënimin e vazhdueshëm, përfshirë edhe kërcënimin e sotëm ndaj Prokurorit të Departamentit për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Rasim Maloku, si dhe familjes së tij.

Këto kërcënime të vazhdueshme ndaj prokurorit janë plotësisht të papranueshme dhe kanë për qëllim që të mbjellin frikë te prokurorët dhe familjet e tyre, si dhe bëhen me qëllim që ata të ndihen të pasigurt në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese dhe ligjore.

Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron opinionin publik se asnjë kërcënim nuk do t'i zmbrapsë prokurorët e shtetit që të punojnë për sundimin e rendit dhe ligjit dhe për fuqizimin e shtetit ligjor, andaj u bëjmë thirrje organeve të sigurisë që këtë rast ta trajtojnë me seriozitetin më të lartë dhe të gjitha ata të cilët qëndrojnë prapa këtyre kërcënimeve t'i nxjerrin para drejtësisë.

Kryesuesi Hyseni: Udhëzuesi i veçantë për politikën ndëshkimore te veprat penale të korrupsionit do të ndikojë në punën e prokurorëve

Prishtinë, 19 shkurt 2020 – Në kuadër të përpjekjeve për fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë është mbajtur një tryezë diskutimi për Udhëzuesin për politikën ndëshkimore te veprat penale të korrupsionit, tryezë kjo, që është organizuar nga Komisioni Konsultativ për Politikën Ndëshkimore, ku morën pjesë Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Skënder Çoçaj, Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, Prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Agron Qalaj, përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, ekspertët britanikë dhe përfaqësues të tjerë institucionesh.

Gjatë zhvillimit të diskutimeve, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, në fjalën e tij të rastit, ka thënë se ky udhëzues do të ndikojë në punën e prokurorëve, me ç'rast do të ketë zbatim të drejtë dhe profesional të politikës ndëshkimore, duke lehtësuar rrethanat për shqiptimin e vendimeve meritore nga gjykatat e vendit. "Në ketë aspekt, Këshilli Prokurorial do të bëjë hapa konkretë për zbatimin e tij dhe do të ofrojë mbështetje të plotë për organizimin e trajnimit për prokurorë, në mënyrë që të ketë rezultate në të ardhmen", ka theksuar Kryesuesi Hyseni.

Rrjedhimisht pati edhe diskutime të tjera interaktive nga pjesëmarrësit e tryezës për çështje dhe problematika që ndërlidhen me politikën ndëshkimore, si dhe pati rekomandime profesionale për hapat e mëtutjeshëm, ngaqë ky udhëzues paraqet një pikënisje specifike për zbatimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për kryesit e moshës mbi 18 vjeçare dhe për personat juridikë.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni, priti në takim Shefin e ri të EULEX-it, Lars – Gunnar Wigemark

Prishtinë, 20 shkurt 2020 – Shprehja e gatishmërisë së lartë për bashkëpunim në proceset e përbashkëta mes Këshillit Prokurorial dhe EULEX-it për fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë dhe për çështjet që ndërlidhen me rëndësinë e monitorimit, këshillimit dhe mënyrës së trajtimit të sfidave dhe përpjekjeve që janë aktuale në sistemin prokurorial, ishin në fokus të diskutimeve në takimin e parë të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, me shefin e ri të EULEX-it, Lars – Gunnar Wigemark, pas marrjes së detyrës nga ana e këtij të fundit.

Në këtë Kontekst, duke uruar atë për detyrën e re dhe duke shprehur gatishmërinë e tij për bashkëpunim në kuadër të kompetencave të ndërsjella, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Hyseni, ka njoftuar Shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, Wigemark, për zhvillimet e fundit që ndërlidhen me zbatimin e prioriteteve strategjike dhe rritjes së efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies së sistemit prokurorial.

Gjithashtu edhe Shefi i ri i EULEX-it ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të stafit që drejton për ofrimin e mbështetjes për institucionet e sistemit prokurorial përmes rolit të monitorimit dhe këshillimit në rrugëtimin e tyre drejt fuqizimit të sundimit të ligjit në Kosovë në pajtim të plotë me praktikat më të mira të BE-së.

Mbahet takimi i 178-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 21 shkurt 2020 – Këshilli Prokurorial i Kosovës ka miratuar sot në takimin e tij të rregullt, të 178-tin me radhë, Raportin vjetor të punës së KPK-së për vitin 2019, i cili është prezantuar nga Kryesuesi Bahri Hyseni, me ç'rast ka shpalosur aspekte të veçanta dhe përmbajtjesore për punën njëvjeçare të Këshillit.

Gjithashtu, Këshilli miratoi themelimin e tri departamenteve të reja në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës: Departamentin për Krim të Organizuar dhe krime të tjera në kompetencë në PSRK, Departamentin për Terrorizëm dhe Departamentin për Korrupsion dhe Krim Financiar, të cilat i ka prezantuar Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi.n

Nga ana tjetër, KPK-ja ka miratuar dy raporte periodike për periudhën korrik – shtator dhe tetor - dhjetor të vitit 2019, që hartohen në kuadër të raportimeve të rregullta për luftimin e krimeve ekonomike, të cilat i prezantoi Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Shqipdon Fazliu.

Po ashtu, Këshilli Prokurorial ka miratuar edhe Kërkesën e Kryeprokurorit të Shtetit për transferimin e tre prokurorëve - dy në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe një në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, si dhe ka marrë vendim për transferimin e një prokurori nga Prokuroria Themelore e Prishtinës në atë të Mitrovicës për një periudhë të caktuar.

Vazhdon draftimi i Rregullores për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së

Prishtinë, 25 shkurt 2020 - Komisioni për Çështje Normative, i udhëhequr nga Kryesuesi, Zejnullah Gashi, ka mbajtur takimin e radhës për vazhdimin e draftimit të Rregullores për organizimin dhe veprimtarinë e KPK-së, në të cilin, përveç anëtarëve të Komisionit, kanë marrë pjesë edhe Drejtori Përgjithshëm i Sekretariatit, Drejtori i NJSHPP-së dhe përfaqësuesit e Zyrës Ligjore.

Gjatë këtij takimi janë diskutuar disa dispozita të kësaj rregulloreje, siç janë: detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit, përgjegjësitë e Zëvendëskryesuesit, kuorumi i takimeve të Këshillit dhe vendimmarrja e Këshillit.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 27 shkurt 2020 – Komisioni për Administrimin e Prokurorive i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga kryesuesja e tij, prokurorja Radica Miliq, ka mbajtur takimin e radhës.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i konceptit të dokumentit për vlerësimin e proceseve të punës në administratën e Prokurorit të Shtetit, themelimi i Grupit punues për zbatimin e këtij procesi, si dhe çështje të tjera të administrimit të prokurorive.

Anëtarët e Komisionit gjatë këtij takimi diskutuan edhe për ngarkesën me lëndë të prokurorëve të departamenteve për krime të rënda në kuadër të prokurorive themelore. Lidhur me këtë, Komisioni ka kërkuar nga Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë hartimin e një raporti të detajuar me të dhënat për numrin e lëndëve, ngarkesën e prokurorëve me lëndë, si dhe informata të tjera relevante, me qëllim që të përgatiten rekomandimet e nevojshme për KPK-në për rekrutim, avancim dhe transferim të prokurorëve.

U mbajt takimi i parë i Grupit të Mentorimit

Prishtinë, 27 shkurt 2020 – Është mbajtur takimi i parë i Grupit punues për Programin e mentorimit, program ky, që vepron në kuadër të Projektit "Forcimi i sistemit të drejtësisë", i cili financohet nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

Gjatë këtij takimi u diskutuan aktivitetet e planifikuara mujore deri në nëntor të këtij viti dhe përfshirja e mundshme në këto aktivitete e Akademisë së Drejtësisë, ZKPSH-së, KGJK-së dhe KPK-së.

Programi i mentorimit, një pjesë e të cilit do të zhvillohet në Kosovë dhe pjesa tjetër në Mbretërinë e Bashkuar, ka për qëllim të rrisë aftësitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të përzgjedhur në trajtimin e korrupsionit të profilit të lartë, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.

Përfitues të këtij programi që është zhvilluar përmes një procesi transparent të intervistimit të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ka marrë aprovimin e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës janë: Vaton Durguti, Kreshnik Radoniqi dhe Violeta Husaj Rogova (gjyqtarë), Atdhe Dema, Armend Hamiti dhe Burim Çerkini (prokurorë).

Vlen të ceket se pas përfundimit të programit, përfituesit e tij do të shpërndajnë njohuritë e fituara te kolegët e tyre, në mënyrë që të përfitojë tërë sistemi i drejtësisë penale në Kosovë.

Mbahet trajnim për protokoll

Prishtinë, 27 shkurt 2020 – Zyrtarë të Sekretariatit dhe Njësitit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe zyrtarë të prokurorive të vendit kanë marrë pjesë në një trajnim dyditor për protokoll dhe etiketë, të organizuar nga Akademia e Drejtësisë.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte marrja e njohurive për protokollin dhe etiketën, si nevojë për organizimin sa më të mirë të aktiviteteve të ndryshme në sistemin prokurorial, për të cilat kërkohen njohuritë për protokollin shtetëror.

Në këtë trajnim, të cilin e ka udhëhequr Drejtori i Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Orhan Hajrizi, janë trajtuar tema që do ta përcjellin sistemin prokurorial gjatë aktiviteteve të ndryshme.

Etiketa, pritja e delegacioneve, veshja zyrtare, komunikimi diplomatik dhe organizimi i evenimenteve, janë disa nga temat e trajtuara në këtë trajnim dyditor.

Vetingu në Kosovë, temë e tryezës së diskutimit

Prishtinë, 28 shkurt 2020 – Si të implementohet një proces në mënyrë që të sigurohet pavarësi e plotë e sistemit të drejtësisë, ishte tema e tryezës së sotme të diskutimit, e organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, me ç'rast është diskutuar për procesin e vetingut në Kosovë, në të cilën kanë marrë pjesë Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni dhe Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Skender Çoçaj, Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane, Ambasadës Britanike dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile në Kosovë.

Në këtë kontekst, në cilësinë e panelistit, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, ka thënë se vetingu duhet të jetë i përhershëm dhe një proces që zhvillohet çdo ditë me anë të mekanizmave legjitimë ligjorë dhe kushtetues.

Kryesuesi Hyseni ka theksuar se kur flasim për perceptimin publik duhet të themi qartazi se në çdo mbledhje apo në secilin deklarim tonin publik nuk kemi thënë asnjëherë se jemi të kënaqur me punën që bëjmë, porse kemi theksuar se jemi duke punuar e angazhuar dhe kemi rezultate të prekshme. "Andaj, më duhet t'ju them se nuk është faji ynë që nuk po bëhet liberalizimi i vizave, sepse kemi shkresë zyrtare që i kemi kryer punët tona. Megjithatë, prapëseprapë, perceptimi është negativ, por nuk është negativ vetëm për sistemin e drejtësisë dhe askush nuk mund te krenohet me këtë, por ky perceptim ekziston edhe për politikën, komunat, legjislativin dhe shumë të tjera, prandaj këtë perceptim duhet ndryshuar për të mirën e shtetit të Kosovës", ka thënë Kryesuesi Hyseni në fjalën e tij para pjesëmarrësve.

Rrjedhimisht, diskutuesit e tjerë të tryezës kanë folur për mënyrat dhe rrugët e mundshme për ta zbatuar një proces të tillë, duke pasur parasysh sfidat dhe problemet aktuale që i ka sistemi i drejtësisë, i cili duhet të jetë i bazuar në ligjet dhe Kushtetutën e vendit.

Sekretariati i KPK-së

Në kuadër të përgjegjësive administrative dhe mbështetjes për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokuroritë, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Lavdim Krasniqi, ka koordinuar punët dhe aktivitetet e administratës së Sekretariatit të KPK-së dhe administratës së prokurorive.

Zyra Ligjore ka hartuar akte juridike, ka analizuar dhe ofruar mendime juridike për aktet e hartuara nga njësitë e Sekretariatit të Këshillit, si dhe ka mbeshtetur komisionet dhe trupat e tjerë në hartimin e akteve nënligjore dhe dokumenteve të tjera.

Zyra për Komunikim Publik (ZKP) ka përcjellë aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit, me ç'rast ka prezentuar punët e tyre përmes mjeteve të informimit publik. Ka përgatitur 20 materiale për publikun. Ka realizuar kërkesat e mediave dhe OJQ-ve lidhur me interesimin e tyre për t'u njoftuar me punët, aktivitetet dhe proceset e zhvilluara, ato në vijim dhe që pritet të zhvillohen në sistemin prokurorial. Po ashtu ka vazhduar me aktivitete për fuqizimin e komunikimit të brendshëm, të jashtëm dhe transparencën.

Zyra për Administrimin dhe Arkivimin e Dokumenteve, gjatë këtij muaji, ka proceduar me këto aktivitete, si në vijim: shkresa hyrëse 44, shkresa dalëse 46, fatura të pranuara nga prokuroritë dhe operatorët e ndryshëm 601 dhe 63 vendime. Zyra për Përkthim dhe Lekturim, e cila vepron në kuadër të Divizionit për Administratë ka përkthyer 570 faqe të materialeve dhe 38 orë përkthim simultan.

Departamenti i Teknologjisë Informative në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë funksionalizuar zbatimin e shkëmbimit të të dhënave nga sistemi elektronik i Policisë në sistemin e prokurorisë (SMIL). Po ashtu, me kërkesë së Ministrisë së Drejtësisë – Shërbimit Korrektues së Kosovës, i është dhënë në shfrytëzim Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Veturave.

Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive i KPK-së

Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive (NJSHPP) ka hartuar një konceptdokument për qëllimin, objektivat dhe metodologjinë e punës së grupit punues për vlerësimin e proceseve të punës në administratën e PSH-së. Janë hartuar raportet krahasuese për harmonizimin e të dhënave statistikore të prezantuara nga prokurorët dhe Shkrimoret për të gjitha prokuroritë themelore për vitin 2019, dhe Është monitoruar performanca e SMIL-it për gjenerimin e raporteve statistikore dhe janë adresuar lëshimet e identifikuara.

Njësiti gjatë muajit shkurt ka hartuar një numër të madh të raporteve dhe statistikave të në bazë të kërkesës së Institutit të Kosovës për Drejtësi. Ka grumbulluar të dhëna statistikore, i ka përpunuar ato dhe ka përpiluar raporte për ngarkesën e prokurorëve me lëndë si dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre, për muajin Janar 2020, gjendjen numerike të lëndëve në prokurori sipas departamenteve dhe llojit të regjistrave, për muajin Janar 2020, dhe gjendjen numerike të lëndëve sipas grupeve të veprave penale nga Mekanizmi përcjellës.

Në bashkëpunim me bashkëpunim me Qendrën për Barazi dhe Liri të Komunitetit LGBT në Kosovë CEL ka organizuar një trajnim në kuadër të projektit "Access to Justice for LGBTI persons in Western Balkans", i mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë për prokurorët e Kosovës. Përfituesit e këtij trajnimi ishin prokurorë, bashkëpunëtorë profesionalë dhe mbrojtës të viktimave nga të gjitha regjione e prokurorive të Kosovës.